

Raporti monitorues i keqinformimit për muajin dhjetor

2023

janar 2024

Action for
Democratic Society
hibrid.info



Raporti monitorues i keqinformimit për muajin dhjetor

Publikues: ADS/hibrid.info

Prishtinë, janar 2024

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS) në kuadër të projektit “Promovimi i gazetarisë objektive dhe lufta kundër dezinformimit”, që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED).

Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NED-it.

Projekti financohet nga:



Projekti realizohet nga:



Përmbajtja

Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

Llojet e fushave tematike

Llojet e publikuesve

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe

Llojet e mediave sociale

Figurat dhe Institucionet më të përfolura

Kontrulli dhe vlerësimi i deklaratave

01. 02. 03. 04. 05. 06. 07. 08.

Hyrje

Ky raport përmbledhës dhe përshkrues, pasqyron gjendjen e informimit (keqinformimit) gjatë muajit dhjetor 2023, bazuar në të dhënat e siguruara nga platforma për kontroll të fakteve – hibrid.info. Formati i këtij raporti është i pari dhe i vetmi i llojit. Është monitorues dhe paraqet gjendjen për një periudhë njëmuajore, ndërsa ky është raporti i tetëmbëdhjetë mujor i publikuar deri më tash.

Ky raport është i ideuar nga platforma hibrid.info e specializuar në kontroll të fakteve, edukim digjital dhe medial, pjesë e OJQ-së kosovare “Action for Democratic Society” (ADS) dhe mbështetet nga fondacioni amerikan “National Endowment for Democracy” (NED) në kuadër të projektit “Promovimi i Gazetarisë Objektive dhe Luftimit të Dezinformatës”.

Në këtë raport monitorues jepet një pasqyrë për formën e përmbajtjeve me karakter informues për dhe rreth ngjarjeve në Kosovë. Në vazhden e këtij raporti paraqiten disa figura (grafika) të dala nga baza e të dhënave të hibrid.info e ndarë përmes disa kategorive të vlerësimit që janë pjesë e metodologjisë për kontroll të fakteve të kësaj platforme.

Raporti trajton 8 kategori krahasuese të të dhënave, duke synuar të japë një sqarim më objektiv të gjendjes së informimit dhe për të shpjeguar tendencat e keqinformimit për këtë periudhë monitoruese.

Kategoritë monitoruese janë:


- Vlerësimet e artikujve keqinformues;
- Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese;
- Fushat mbi të cilat janë krijuar dhe shpërndarë artikujt keqinformues;
- Llojet e mediave që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Kategorizimi i mediave në gjuhën shqipe dhe serbe që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e mediave sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e publikuesve në mediat sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Institucionet dhe personat e përfolur në artikujt keqinformues;
- Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave.

Përmbajtja e trajtuar nga hulumtuesit e hibrid.info, e që ka shërbyer për ndërtimin e këtij raporti, është kryesisht ajo e publikuar në gjuhën shqipe dhe serbe.

Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas kategorive vlerësuese




Nga 67 përmbajtje keqinformuese që janë trajtuar gjatë muajit dhjetor 2023 tregojnë për ndryshime për sa i përket trendeve të përmbajtjeve keqinformuese të publikuara nga media dhe publikues të ndryshëm.

Përderisa gjatë muajve të fundit artikujt “clickbait”, dezinformatat dhe përmbajtjet e paverifikuara kanë mbizotëruar, gjatë këtij muaji lajmet e rreme janë ato që prijnë sa i përket kategorive vlerësuese. Bazuar në monitorimin e bërë, del që lajmet e rreme kryesisht zënë vend në rrjetin social TikTok dhe kanë mbizotëruar gjatë këtij muaji për arsye se janë publikuar një numër i konsiderueshëm keqinformatash në lidhje me armatosjen e FSK-së, të cilat janë vlerësuar si lajm i rremë.

Lajmet e rreme pasohen nga dezinformatat të cilat vazhdojnë të radhiten në pozitën e dytë (ashtu si në muajin nëntor). Gjatë këtij muaji, përmbajtje të pasakta kryesisht të publikuara në mediat sociale dhe portale të dyshimta nga tema të ndryshme sociale janë vlerësuar si dezinformatë duke bërë që kjo kategori të zë vend pas lajmeve të rreme.

Artikujt “clickbait”, si mënyra më e shpeshtë e keqinformimit nga portalet informative (mediat) gjatë këtij muaji janë radhitur në pozitën e tretë. Përderisa gjatë muajit paraprak artikujt “clickbait” kishin mbizotëruar, gjatë këtij muaji këto përmbajtje janë reduktuar duke i lënë vendin lajmeve të rreme të publikuara në mediat sociale.



30% e artikujve keqinformues të trajtuar kanë marrë vlerësimin “lajm i rremë”.

Analizë e llojeve të vlerësimeve

1.1.01

01. Lajm i rremë

Pothuajse të gjitha lajmet e rreme të trajtuara janë publikuar nga faqe apo llogari në mediat sociale. Pjesa dërrmuese e tyre janë krijuar e publikuar në fushën e sigurisë. Në fushën e sigurisë u publikuan lajme të rreme ndërlidhur me armatosjen e FSK-së dhe veriun e Kosovës. Që nga marrëveshja e arrirë për blerjen e disa dronëve nga ana qeverisë së Kosovës, disa llogari në TikTok kanë krijuar dhe shpërndarë lajme të rreme edhe për furnizime tjera me armë nga më të ndryshmet. Ndërlidhur me sigurinë u publikuan edhe disa lajme të rreme për veriun, konkretisht me pretendimet e rreme se janë shfaqur grupi mercenar “Wagner”, ka manovra rreth kufirit Kosovë-Serbi, si dhe për vrasjen e tre policëve atje.

03. Clickbait

Një përqindje e konsiderueshme e artikujve “clickbait” janë publikuar nga fusha e sociale, pasuar nga kronika e zezë, ligji dhe sporti të cilat kryesisht u publikuan në media. Temat nga fusha sociale kishin të bënin me sekuestrim të drogës, sulm nga qentë endacak, programin e vet-punësimit etj, për të cilat nuk qartësohet në titull. Ndërsa ato të kronikës së zezë ishin për raste tragjike, vrasje, aksidente të cilat ndërlidhen me ngjarje që nuk kanë ndodhur në Kosovë dhe që në titujt e tyre nuk bëhet e ditur vendndodhja e ngjarjes, duke lënë hapësirë për nxitje klikimesh dhe keqinformim.

05. Mashtrim

Të gjitha mashtrimet janë publikuar nga faqe në mediat sociale nga fusha e sociale. Përmbajtjet mashtruese janë publikuar lidhur me temën e dhënies së kredive, ku faqe të dyshimta kanë publikuar shpallje të ndryshme të rreme për dhënie kredish në shuma të ndryshme të parasë.

02. Dezinformatë

Gjatë muajit dhjetor u publikuan dezinformata nga fusha e sociale (12%), e sigurisë (6%) dhe e politikës (4%). Këto dezinformata u publikuan kryesisht nga mediat sociale (12%) dhe portalet e dyshimta (7%). Dezinformatat u publikuan lidhur me disa tema të caktuara ku vlen të përmendet ajo e veriut dhe e protestave në Serbi. Për veriun u publikuan përmbajtje të pasakta në gjuhën shqipe me pretendime se kanë hyrë 200 persona të armatosur dhe se ka pasur shpërthim në veri. Ndërsa për protestat në Serbi u publikuan dezinformata nga mediat në gjuhën serbe me pretendime për përfshirjen e kryeministrit Kurti në këto protesta nëpërmjet mediave dhe llogarive në mediat sociale.

04. Përmbajtje e paverifikuar

Të gjitha përmbajtjet e paverifikuara janë publikuar nga fusha e sociale dhe e sigurisë. Këto përmbajtje të paverifikuara janë publikuar nga faqe dhe llogari në mediat sociale në gjuhën shqipe. Vazhdimi i konfliktit Izrael-Hamas i nisur me 7 tetor të vitit të kaluar (2023) ka bërë që shumë përmbajtje të paverifikuara lidhur me konfliktin të publikohen në mediat sociale, ku kanë dominuar imazhe të gjeneruara me inteligjencë artificiale apo fotografi të vjetra.

06. Dezinformatë/ Clickbait

Përmbajtja e publikuar në media reale e cila është vlerësuar clickbait / manipulim i fakteve kishte të bënte me dorëheqjen e Blerim Velës, ish-shefi i stafit të presidencës së Kosovës.


Artikuj të tjerë me përmbajtje keqinformuese janë vlerësuar në kategoritë: gabim, përmbajtje e paverifikuar/dezinformatë, përmbajtje e paverifikuar/satirë, deepfake dhe manipulim i fakteve.

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

2

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave




Në bazë të monitorimit të përmbajtjeve keqinformuese, mediat dhe publikuesit e ndryshëm kanë publikuar më së shumti artikuj keqinformues për konfliktin Izrael-Hamas (16%) dhe armatosjen e FSK-së (15%). Këto dy tema kanë vazhduar të përdoren për të keqinformuar në mediat sociale nga faqe të ndryshme.

Vazhdimi i konfliktit Izrael-Hamas ka bërë që kjo temë të përdoret për të keqinformuar në mediat sociale edhe gjatë këtij muaji. Keqinformatat lidhur me këtë temë u publikuan nga fusha e sociale dhe e sigurisë, kryesisht fotografi të vjetra dhe imazhe të gjeneruara me inteligjencë artificiale. Ndonëse kjo temë mbizotëron gjatë këtij muaji dhe konflikti është duke vazhduar, përmbajtjet keqinformuese lidhur me ngjarjen kanë pësuar rënie në përmbajtjet në gjuhën shqipe, duke bërë që kjo temë të reduktohet në ekosistemin keqinformues.

Tema lidhur me armatosjen e Forcave të Sigurisë së Kosovës (FSK) vazhdon të përdoret për keqinformata edhe gjatë muajit dhjetor 2023. Spekulimet për blerje të armëve nga ana e Qeverisë së Kosovës për armatosjen e FSK-së kanë vazhduar të qarkullojnë duke filluar nga muaji qershor kur ishte bërë e ditur blerja e dronëve.

Gjatë muajit dhjetor, po ashtu u publikuan përmbajtje keqinformuese lidhur me veriun nga fusha e sigurisë. Këto keqinformata të publikuara në mediat sociale përmbanin pretendime të rreme për gjendjen në veri duke u ndërlidhur me futjen e grupeve të armatosura dhe grupit mercenar Wagner, si dhe manovra ushtarake përreth kufirit.

Në kuadër të muajit dhjetor, janë publikuar përmbajtje keqinformuese ndërlidhur me pretendime rreth rastit të vrasjes së Liridona Murselit, shpallje për dhënie kredish në shuma të caktuara dhe keqinformata për protestën në Serbi.



51% e temave kryesore janë për konfliktin Izrael-Hamas, armatosjen e FSK-së, veriun, vrasjen e Liridona Murselit, dhënie kredish dhe protestën në Serbi.

Analizë e kontrolleve të fakteve sipas temave

2.1

Në vijim analizohen, në formë të përmbledhur, katër temat kryesore të trajtuara nga media dhe publikues të ndryshëm, sipas matjeve të platformës hibrid.info, përmes metodologjisë së kontrollit të fakteve.

01. Konflikti Izrael-Hamas

Pothuajse të gjitha përmbajtje të trajtuara lidhur me temën janë publikuar nga faqe dhe llogari në mediat sociale, e që shumica prej tyre janë vlerësuar si përmbajtje e paverifikuar. Këto përmbajtje janë publikuar nga fusha e sigurisë dhe sociale. Përmbajtjet lidhur me sigurinë kishin të bënin me fotografi dhe pamje të vjetra me të cilat pretendohet rrejshëm për armatosjen e Izraelit nga ana SHBA-së dhe Turqisë, apo edhe gjendjen aktuale në Gaza. Ndërsa keqinformata nga fusha e sociale kishin të bënin me imazhe të fëmijëve në mesin e gërmadhëve por të cilat ishin të gjeneruara me inteligjencë artificiale, si dhe protesta për shkëmbim të pengjeve apo edhe krijimin e vendbanimeve të reja izraelite në Gaza.

03. Veriu

Rreth temës së veriut vazhdojnë të publikohen keqinformata nga fusha e sigurisë. Të gjitha këto përmbajtje janë publikuar në mediat sociale e të cilat janë vlerësuar si dezinformata dhe lajm i rremë. Keqinformata lidhur me këtë temë kanë përfshi pretendime të rreme për manovra ushtarake në kufirin Kosovë-Serbi, për hyrjen e 200 personave të armatosur në veri dhe paraqitjen e grupit mercenar Wagner atje.

02. Armatosja e FSK-së

Përmbajtjet keqinformuese rreth furnizimit me armë të FSK-së janë publikuar nga llogari të ndryshme në TikTok në gjuhën shqipe. Këto përmbajtje janë në fushën e sigurisë me pretendime të rreme se pajisje të ndryshme ushtarake janë blerë nga ana e qeverisë së Kosovës, apo janë dhuruar nga shtetet si Turqia dhe SHBA-ja.

04. Vrasja e Liridona Murselit


Keqinformatat e publikuara lidhur me këtë temë nga kronika e zezë, janë publikuar në media sociale dhe media reale. Lidhur me temën, nga faqe në mediat sociale janë publikuar dy lajme të rreme me pretendimet se i dyshuari i rastit, Naim Murseli është sulmuar fizikisht në burg dhe se i ka dhënë fund jetës së tij, si dhe një video deepfake ku paraqitet imazhi i viktimës të cilës i është shtuar një regjistrim zanor duke pretenduar që ajo po flet në lidhje me vrasjen e saj. Ndërsa në media reale është publikuar një artikull i vlerësuar si “clickbait” ku opinioni i një analisti është përdorur në titull si lajm, duke pretenduar se kanë filluar hetimet ndaj ish-presidentit të Kosovës Behgjet Pacolli në lidhje me rastin e fundit të vrasjes së gruas në Prishtinë.

Llojet e fushave

Bazuar në monitorimin dhe përmbajtjet keqinformuese të trajtuara gjatë muajit dhjetor del se publikues të ndryshëm (media reale, portale të dyshimta dhe mediat sociale) kanë prodhuar dhe shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese në fushën e sociale. Kjo vjen si rezultat i përmbajtjeve keqinformuese të trajtuara të cilat kanë përfshirë tema të ndryshme sociale, ku të gjitha përmbajtjet mashtruese, dhe një mori e konsiderueshme e artikujve “clickbait” dhe dezinformata janë pikërisht nga kjo fushë.

FUSHAT KRYESORE

Këtu janë renditur 6-të fushat kryesore



Përderisa gjatë muajve paraprak (shtator, tetor, nëntor) kanë mbizotëruar përmbajtjet keqinformuese nga fusha e sigurisë, gjatë këtij muaji temat sociale janë ato që kanë dominuar në ekosistemin keqinformues, pasuar nga temat e sigurisë. Një pjesë e konsiderueshme e përmbajtjeve ndërlidhur me konfliktin Izrael-Hamas, si tema kryesore e këtij muaji, kanë qenë nga fusha e sociale. Përmbajtje keqinformuese nga fusha sociale pasohen nga ato të sigurisë, ku janë publikuar keqinformata ndërlidhur me armatosjen e FSK-së, veriun dhe disa artikuj për konfliktin Izrael-Hamas. Përkundër faktit që nuk ndërlidhen njëra me tjetrën këto dy fusha përbëjnë më shumë se 73% të përmbajtjeve keqinformuese të trajtuara për muajin dhjetor.


Sa i përket keqinformatave nga kronika e zezë shohim që kemi rënie në përqindje krahasuar me muajin paraprak (2023), duke u ndërlidhur me faktin se jo të gjitha përmbajtjet e vlerësuara si “clickbait” kanë qenë nga kjo fushë, ashtu si në muajin paraprak (nëntor 2023).

Një numër i konsiderueshëm i përmbajtjeve keqinformuese nga fusha e sociale janë publikuar në media sociale (24%), pasuar nga portale të dyshimta (9%) dhe media reale (9%). Shumica e përmbajtjeve nga kjo fushë janë vlerësuar si dezinformata (12%), clickbait (10%), përmbajtje e paverifikuar (9%) dhe mashtrim (4%). Përderisa dezinformatat, përmbajtjet e paverifikuara dhe mashtrimet janë publikuar në media sociale dhe portale të dyshimta, shumica e përmbajtjeve “clickbait” janë publikuar në media reale.

Ndërkaq, pothuajse se të gjitha përmbajtjet keqinformuese të trajtuara nga fusha e sigurisë u publikuan nga faqe dhe llogari në mediat sociale. Shumica e këtyre përmbajtjeve janë vlerësuar si lajm i rremë dhe ndërlidheshin me armatosjen e FSK-së dhe konfliktin Izrael-Hamas.

Përmbajtjet keqinformuese nga fusha e kronikës së zezë janë publikuar në media reale dhe media sociale të cilat janë vlerësuar si “clickbait”, lajm i rremë dhe deepfake. Përderisa artikujt “clickbait” të publikuar në media reale kishin të bënin me raste të ndryshme tragjike, lajmet e rreme dhe deepfake ndërlidheshin me vrasjen e Liridona Murselit.

Ndërsa përmbajtje keqinformuese nga fusha e politikës janë publikuar në mediat sociale në gjuhën shqipe dhe në media reale në gjuhën serbe. Përmbajtjet keqinformuese në gjuhën shqipe kishin të bënin me politikën e Kurtit si lajm i rremë, si dhe dokumentin e vendimit për lirim nga burgu të Kurtit në vitin 2001 si manipulim i fakteve. Ndërsa, ato në gjuhën serbe kishin të bënin me pretendime të rreme për përfshirjen e kryeministrit Kurti në protestat e opozitës në Serbi, të cilat u vlerësuan si dezinformata.



90% e përmbajtjeve keqinformuese të trajtuara janë për socialen, sigurinë, kronikën e zezë dhe politikën.

Llojet e publikuesve


4

Në bazë të gjetjeve dhe trajtimeve të përmbajtjeve keqinformuese del që numri më i madh i keqinformatave janë publikuar nga mediat sociale prej 65%. Krahasuar me muajin nëntor, mediat sociale kanë shënuar rritje prej 13% (nga 52% në nëntor 2023, në 64% në muajin dhjetor 2023). Kjo vjen si rezultat i publikimit të të gjitha lajmeve të rreme dhe dezinformatave nga faqe dhe llogari në mediat sociale.

Ndërsa përmbajtjet keqinformuese të trajtuara në mediat reale kanë pësuar rënie prej 13% (nga 38% në nëntor 2023, në 25% në muajin dhjetor 2023) si rezultat i publikimit të pothuajse vetëm artikujve “clickbait” në mediat reale, të cilat gjatë këtij muaji ishin më të reduktuara.

Në portalet e dyshimta, ashtu si në muajin nëntor, janë publikuar dhe trajtuar pothuajse numër i njëjtë i përmbajtjeve keqinformuese (nga 10% në nëntor 2023, në 11% në muajin dhjetor 2023). Një pjesë e keqinformatave të vlerësuara si “clickbait” dhe dezinformatë janë publikuar nga portalet e dyshimta.

DALLIMI NË PËRQINDJE NË MES
TË PUBLIKUESVE ME
PËRMBAJTJE KEQINFORMUESE




89% e artikujve me përmbajtje keqinformuese janë publikuar nga publikuesit media sociale (65%) dhe në mediat reale (24%).

5

Klasifikimi i publikimeve në gjuhën shqipe dhe serbe

Kjo matje tregon se në cilën gjuhë janë publikuar artikujt keqinformues të monitoruar gjatë periudhës njëmuajore, duke i kategorizuar mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhë të tjera në lidhje me raportimet e tyre për dhe rreth zhvillimeve në Kosovë.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE



Marrë parasysh se mostra e monitorimit nga platforma “hibrid.info” fokusohet në përmbajtjet keqinformuese në gjuhën shqipe të publikuara në media, portale të dyshimta dhe faqe e llogari në mediat sociale, atëherë publikimet në këtë gjuhë mbizotërojnë në trajtim me 94%. Ndërsa në gjuhën serbe monitorohen kryesisht vetëm raportimet keqinformuese në mediat reale lidhur me zhvillimet për dhe rreth Kosovës e që trajtohen pikërisht ato përmbajtje, të cilat rezultuan me 5% gjatë këtij muaji.

Analiza e artikujve të kësaj kategorie

5.1

Në këtë seksion të raportit analizohen publikimet keqinformuese të publikuara nga mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhët e tjera. Në vijim është përshkrimi i ndërlidhjes së tyre mes kategorizimeve, fushave dhe temave të trajtuara.

01. Publikimet në gjuhën shqipe

Përmbajtje keqinformuese të trajtuara në gjuhën shqipe gjatë muajit dhjetor janë publikuar nga faqe dhe llogari në media sociale prej 65%, ndërsa 35% në media reale dhe 9% në portale të dyshimta. Përderisa në muajin nëntor kanë mbizotëruar artikujt “clickbait”, në muajin dhjetor lajmet e rreme me 30% radhiten të parat për shkak pjesë dërrmuese e përmbajtjeve nga fusha e sigurisë janë vlerësuar me këtë kategori. Artikujt “clickbait” janë radhitur si të dytat me 20%, pasuar nga dezinformata me 18%. Përmbajtjet keqinformuese nga fusha e sociales dominojnë me 39%, pasuar nga ajo e sigurisë me 32% dhe kronika e zezë me 11%.

02. Publikimet e mediave në gjuhën serbe (për dhe rreth Kosovës)

Të gjitha përmbajtjet keqinformuese të trajtuara në gjuhën serbe janë publikuar nga mediat reale që kanë trajtuar tema të politikës dhe sociales. Publikimet e mediave në gjuhën serbe janë vlerësuar si dezinformata dhe përmbajtje e paverifikuar/dezinformata. Përderisa dezinformata kishte të bënte me protestat e opozitës në Serbi ku pretendohet rrejshëm se llogaria robot e kryeministrit Kurti në platformën X ka postuar për protestën e opozitës në Serbi, si dhe që Kurti i ka urdhëruar mediat që t'i japin hapësirë të plotë protestës së opozitës në Serbi. Ndërsa përmbajtja e paverifikuar/dezinformata kishte të bënte me pretendimin se për përfshirjen e Prishtinës zyrtare dhe strukturave komunale në rastin e Kishës Ortodokse në Podujevë, ku At Nikolla Xhufka kishte prezantuar një meshë.

03. Publikimet në gjuhën angleze


Disa llogari të huaja në rrjetin social X (ish-Twitter) dhe në Facebook kanë publikuar një imazh të këngëtares me prejardhje shqiptare, Dua Lipa duke i mbështetur mbishkrimin “Dua Lipa qëndron me Palestinën”. Pas verifikimit të fakteve është gjetur se një qëndrim i tillë nuk qëndron dhe për këtë është vlerësuar si dezinformata.

Llojet e mediave sociale

Në këtë seksion analizohen vetëm artikujt keqinformues të publikuar dhe shpërndarë nga publikuesit në mediat sociale dhe në këtë rast nuk përfshihen publikimet në mediat tjera (mediat reale dhe portalet e dyshimta).

Ngjashëm si në muajin paraprak, edhe gjatë muajit dhjetor janë trajtuar përmbajtjet keqinformuese të publikuara në mediat sociale në përqindje të njëjtë ku prinë Facebook (55%) me 1% më shumë krahasuar me muajin e kaluar. Facebook pasohet nga TikTok me 45%, 1% përqind më pak krahasuar me muajin e kaluar.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË MEDIAT SOCIALE




Llojet e publikuesve në mediat sociale

6.1

Kjo matje, përmes të dhënave monitoruese, analizon ndërveprimin në mediat sociale sa i përket publikimit dhe shpërndarjes së artikujve keqinformues nga publikues të ndryshëm të mediave sociale. Kjo bëhet përmes këtyre kategorive kryesore të publikuesve: faqeve, llogarive, mediave dhe kanaleve që menaxhohen nga përdorues të mediave sociale.

Keqinformata në gjuhën shqipe, gjatë muajit dhjetor 2023, më së shumti u publikuan nga faqet e ndryshme në Facebook (45%), pasuar nga mediat (7%) dhe llogaritë (2%). Edhe gjatë këtij muaji, faqet në Facebook kanë mbizotëruar sa i përket shpërndarjes së artikujve keqinformues, duke u pasuar nga llogari në TikTok (45%).

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË MEDIAT SOCIALE



Analiza e llojeve të publikuesve në mediat sociale

Në vijim analizohen këto kategori të mediave sociale në ndërlidhje me publikimet dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

01. Facebook

Në përmbajtjet keqinformuese të publikuara në Facebook kanë dominuar përmbajtjet e paverifikuara (20%), dezinformata (9%) dhe lajmi i rremë (9%). Shumica e përmbajtjeve keqinformuese të publikuara në Facebook janë nga fusha e sociale dhe e sigurisë. Nga fusha e sociale kryesisht u publikuan keqinformata nga konflikti Izrael-Hamas në kontekst social, duke vazhduar me tema tjera si dhënie kredish, punë në Gjermani, subvencionimin e energjisë elektrike, pagat e zjarrfikësve. Pjesa dërrmuese e përmbajtjeve keqinformuese nga fusha e sigurisë ishin për konfliktin Izrael-Hamas dhe armatosjen e FSK-së.


02. TikTok

Pothuajse të gjitha përmbajtjet keqinformuese të publikuara nga llogari në TikTok janë në fushën e sigurisë të cilat janë vlerësuar si lajm i rremë dhe dezinformatë. Në TikTok u publikuan lajme të rreme dhe dezinformata me pretendime për pajisjen e FSK-së me armatime të ndryshme si, helikopterë e aeroplanë. Krahas kësaj, janë publikuar edhe lajme të rreme dhe dezinformata lidhur me veriun me pretendime të rreme për paraqitjen e pjesëtarëve të Wagner-it dhe grupeve të armatosura dhe manovrave ushtarake përreth kufirit Kosovë-Serbi.

Figurat dhe institucionet më të përfolura

Kjo matje analizon të dhënat se cilat kanë qenë institucionet dhe personalitetet (figura publike e politike) më të përfolura përmes monitorimit të artikujve me përmbajtje keqinformuese.

RENDITJA E INSTITUCIONEVE MË TË PËRFOLURA SIPAS PËRQINDJES




Në disa nga përmbajtjet keqinformuese të trajtuara janë përfolur edhe institucione të caktuara duke u ndërlidh me keqinformatat. Institucionet e sigurisë vazhdojnë të jenë më të përfolurat në keqinformatat e krijuara dhe të shpërndara nga publikues të ndryshëm në gjuhën shqipe.

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) u përfol në përmbajtjet keqinformuese të publikuara në mediat sociale (TikTok) me pretendimet se FSK-ja do të pajiset me automjete ushtarake, helikopterë dhe aeroplanë.

Policia e Kosovës është institucioni i dytë më i përfolur në përmbajtjet keqinformuese. Ky institucion u përfol në publikime në TikTok ku u pretendua rrejtshëm se janë vlarë tre policë në Mitrovicë, si dhe se presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan e ka vlerësuar Policinë e Kosovës.

Të gjitha institucionet e përmendura në tabelën e mësipërme janë përfolur nga një herë në përmbajtjet keqinformuese të publikuara nga publikues të ndryshëm gjatë muajit dhjetor 2023.

RENDITJA E PERSONAVE MË TË PËRFOLUR SIPAS PËRQINDJES



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është figura më e përfolur në përmbajtjet keqinformuese të publikuesve të ndryshëm edhe gjatë muajit dhjetor 2023. Kurti vazhdon të jetë një prej figurave më të përfolura në përmbajtjet keqinformuese. Ai, gjatë këtij muaji, u përfshi në përmbajtjet keqinformuese në gjuhën shqipe të publikuara në mediat sociale ndërlidhur me publikimin e deepfake aeroplanit me mbishkrimin “Albin Kurti – Kosova USA”, si dhe rreth dokumentit të vendimit për lirin e tij nga burgu në vitin 2001.


Naim Murseli, si i dyshuari kryesor për vrasjen e Liridona Murselit, është figura e dytë më e përfolur gjatë këtij muaji. Murseli u përfol në përmbajtjet keqinformuese të publikuara në TikTok ku u pretendua rrejtshëm se ai ishte sulmuar fizikisht në burg, apo edhe se i ka dhënë fund jetës së tij.

Të gjitha personalitetet tjera të përmendura, në tabelën e mësipërme, janë përfolur nga një herë në përmbajtjet keqinformuese të publikuara nga publikues të ndryshëm gjatë muajit dhjetor 2023.

Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave

Hibrid.info, përveç kontrollit dhe analizës së artikujve mediatik, bën edhe kontrollin dhe vlerësimin e deklaratave të zyrtarëve të lartë politikë e institucionalë, si dhe figurave që kanë ndikim publik. Vlerësimi i këtyre figurave, sipas metodologjisë së hibrid.info, bëhet në kategoritë e vërtetësisë, qëndrueshmërisë dhe përmbajtjes së premtimeve.

RENDITJA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT TË DEKLARATAVE



Në kuadër të përmbajtjes së monitoruar gjatë muajit dhjetor, hibrid.info ka kontrolluar dhe analizuar dy deklarata.

Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli kishte deklaruar se pagat e minatorëve të Trepçës, në bazë të marrëveshjes së arritur ndërmjet sindikatës së minatorëve dhe disa deputetëve, do të ekzekutohen në datat 6 deri në datën 10 të çdo muaji. Por pas verifikimit dhe hulumtimit nga hibrid.info, është vërtetuar se pavarësisht deklaratës së ministres, pagat e muajit tetor nuk janë ekzekutuar deri në datën 27 nëntor.

Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia është deklaruar se vdekshmëria e foshnjave në Kosovë, është rreth 7 promil, për tash e disa vite. Por pas verifikimit dhe hulumtimit nga hibrid.info, me anë të disa raporteve të organizatave ndërkombëtare, janë gjetur të dhëna që bien ndesh me deklarinimin e ministrit Vitia rreth kësaj çështjeje.

Metodologjia

Për hartimin e këtij raporti monitorues janë përdorur metodat kuantitative dhe ato kualitative.

Sa i përket metodave kuantitative, fillimisht është krijuar baza e të dhënave nga ADS/hibrid.info me qëllim të zbërthimit dhe analizimit të detajuar të trendëve të keqinformimit. Përmes kësaj baze të të dhënave, e cila mirëmbahet dhe përditësohet në baza të rregullta ditore nga stafi i ADS/hibrid.info, monitorohen rregullisht artikujt me përmbajtje keqinformuese.

Kjo nënkupton se të gjithë artikujt e publikuar në platformën hibrid.info vendosen në bazën e të dhënave dhe kjo e fundit shërben si një ndër burimet kryesore për përgatitjen e raportit monitorues. Për më tepër, metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave të paraqitura në raportin monitorues bën të mundur filtrimin e të dhënave në baza ditore, javore e mujore, dhe atë në formë kryesisht kuantitative, për të kuptuar më qartë fenomenin e keqinformimit të atyre artikujve të analizuar për këtë periudhë monitoruese një mujore sipas kategorive e vlerësimeve të ndryshme.

Krahas kësaj, një burim tjetër i rëndësishëm për këtë raport është metodologjia e ADS/hibrid.info (e publikuar në faqen e hibrid.info) për luftën kundër çrregullimit informativ. Metodologjia, e cila është e bazuar para së gjithash në metodat kualitative, është hartuar nga stafi profesional i ADS/hibrid.info dhe është në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare për kontroll të fakteve, gjegjësisht sipas udhëzimeve të Rrjetit Ndërkombëtar për Kontroll të Fakteve (IFCN). ADS/hibrid.info është anëtarë me të drejta të plota në këtë mekanizëm ndërkombëtar - IFCN.

Ky raport monitorues përfshin periudhën nga 1 deri më 31 dhjetor 2023, në të cilën janë trajtuar 67 përmbajtje keqinformuese.

Përfundime

Ky raport i shkurtër monitorues paraqet një pasqyrë të gjendjes njëmuajore të informimit (keqinformimit) gjatë muajit dhjetor 2023, nga të dhënat e platformës për kontroll të fakteve – hibrid.info.

Në bazë të monitorimit të 67 përmbajtjeve keqinformuese për muajin dhjetor 2023, publikuesit e ndryshëm kanë krijuar dhe shpërndarë më së shumti lajme të rreme me 30%, pasuar nga dezinformata me 22% dhe “clickbait” me 21%. Pjesa dërmuese e lajmeve të rreme janë publikuar në mediat sociale (TikTok) nga fusha e sigurisë, konkretisht për armatosjen e FSK-së dhe veriun. Dezinformatat janë publikuar kryesisht nga fusha e sociale dhe sigurisë kryesisht të publikuara në mediat sociale dhe portale të dyshimta. Pothuajse të gjithë artikujt “clickbait” janë publikuar nga media reale nga fusha sociale dhe kronika e zezë. Një numër i konsiderueshëm i përmbajtjeve të rreme lidhur me armatosjen e FSK-së të publikuara në TikTok kanë bërë që lajmi i rremë të dominojë në këtë muaj.

Konflikti Izrael-Hamas, përkundër që po vazhdon, përmbajtjet e paverifikuara lidhur me të janë reduktuar por, megjithatë, radhitet e para sa i përket temave. Një numër i konsiderueshëm i përmbajtjeve të paverifikuara vazhdojnë të publikohen nga llogari në mediat sociale me përmbajtje kryesisht sociale lidhur me konfliktin. Në TikTok vazhdon publikimi i përmbajtjeve me pretendime të rreme për furnizimin ushtarak të FSK-së me pajisje të ndryshme. Në TikTok llogari të ndryshme publikojnë fotografi ku shihen tanke, dronë, helikopterë dhe aeroplanë, nëpërmjet së cilave pretendohet rrejshëm që i janë dhuruar apo blerë nga qeveria e Kosovës për FSK-në. Për shkak që zhvillimet në veri vazhdojnë të jenë të herëpashershme, kjo temë vazhdon të përdoret për të krijuar dhe shpërndarë keqinformata të ndryshme.

Edhe pse nuk ndërlidhen njëra me tjetrën, fusha sociale, e sigurisë dhe e kronikës së zezë janë tri fushat kryesore që e kanë përbërë pjesën dërmuese (83%) të përmbajtjeve keqinformuese të publikuar për muajin dhjetor 2023. Shumica e keqinformata nga fusha e sociale u vlerësuan si dezinformata që u publikuan mediat sociale dhe portale të dyshimta, “clickbait” artikuj të publikuara në kryesisht në media dhe përmbajtje të paverifikuara të publikuara në mediat sociale. Përmbajtjet keqinformuese lidhur me konfliktin Izrael-Hamas por nga konteksti social (përderisa në muajin nëntor ishin nga fusha e sigurisë kryesisht), si dhe

ato për dhënie kredish dhe lidhur me tema të ndryshme sociale ka bërë që kjo fushë të mbizotëruar gjatë muajit dhjetor 2023. Ndërsa, keqinformatat e trajtuara për armatosjen e FSK-së, veriun dhe një pjesë e keqinformatave nga konflikti Izrael-Hamas ka ndikuar që kjo fushë të radhitet e dyta, ndërsa pasohet nga kronika e zezë me keqinformata lidhur me vrasjen e Liridona Murselit dhe raste e ndryshme tragjike.

Gjatë dhjetorit keqinformatat e publikuara në mediat sociale kanë mbizotëruar me 64%, duke u pasuar nga mediat reale me 25% dhe portalet e dyshimta me 11%. Në bazë të mostrës monitoruese, 94% e përmbajtjeve keqinformuese janë publikuar nga media dhe faqe në mediat sociale në gjuhën shqipe, ndërsa 5% në mediat në gjuhën serbe dhe një përmbajtje në gjuhën angleze. Përderisa pjesa dërrmuese e përmbajtjeve në gjuhën shqipe janë nga fusha e sociale dhe sigurisë, ato në gjuhën serbe janë nga politika dhe socialja. Pjesa më e madhe e përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe janë vlerësuar si lajm i rremë, “clickbait” dhe dezinformatë, ndërsa në gjuhën serbe dezinformatë dhe përmbajtje e paverifikuar/dezinformatë. Sa i përket publikimeve nga publikuesit në media sociale, 55% janë publikuar në Facebook, duke u pasuar nga TikTok me 45%.

Kryeministri Albin Kurti dhe i dyshuari për vrasjen e Liridona Murselit, Naim Murseli janë dy figurat që janë përfolur më së shumti në përmbajtjet e trajtuara, ndërsa Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) institucioni më i përfolur gjatë nëntorit.

Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli kishte deklaruar se pagat e minatorëve të Trepçës, në bazë të marrëveshjes se arritur ndërmjet sindikatës së minatorëve dhe disa deputetëve, do të ekzekutohen në datat 6 deri në datën 10 të çdo muaji. Por pas verifikimit dhe hulumtimit nga hibrid.info, është vërtetuar se pavarësisht deklaratës së ministres, pagat e muajit tetor nuk janë ekzekutuar deri në datën 27 nëntor.

Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia është deklaruar se vdekshmëria e foshnjave në Kosovë, është rreth 7 promil, për tash e disa vite. Por pas verifikimit dhe hulumtimit nga hibrid.info, me anë të disa raporteve të organizatave ndërkombëtare janë gjetur të dhëna që bien ndesh me deklarinimin e ministrit Vitia rreth kësaj çështjeje.

HIBRIDO.INFO